



Thirrje publike për furnizim me pajisje të fitnessit dhe montimin e tyre te Parku e Paqes

Emri i nënprojektit: EscapeXercise

Organizata: Escape

Kushtet:

Kompania duhet të jetë e pajisur me standardet: ISO 9001 dhe ISO 14001,

Produktet duhet të jenë të ndërtuara në bazë të standardeve: EN 16630 dhe EN 1176.

Në çmim duhet të përfshihet edhe montimi.

Afati i përfundimit të projektit është më datë 09.06.2024.

Aplikimet të dorëzohen në e-mailin [ojq.escape@gmail.com](mailto:ojq.escape@gmail.com)

Shtyllat paralele të shkallëzuara

Shtyllat bartëse të shufrave të shkallëzuara duhet të jenë nga profilet 100x100x2.5 mm Shufrat e celikut të shkallëzuara duhet të jenë nga gypat 32x2.5 mm të cilat janë të salduara duke përdorur metodën e saldimit me hark metalik të gazit.

Shkallët komando

Shtyllat e shkallëve komando duhet të përbëhen nga 4 profileve me dimensione të paktën 100x100x2,5 mm. Shkallët mbajtëse duhet të prodhohen duke bashkuar fllanxhat e lidhjes nga një tub minimal 32x2,5 mm me metodën e saldimit me hark metalik me gaz. Për montimin e dorezave të shufrave në shtyllat mbajtëse duhet të përdoren dadot dhe bulonat e kokës me kamer të veshur me gjeomet. Dimensionet e komponentëve të produktit duhet të prodhohen në dimensionet minimale.

Shkallët vertikale

- Shufrat mbajtëse të shkallëve duhet të prodhohen nga profilet me dimensione të paktën 100x100x2,5 mm.

Shkallët e ngjitjes duhet të prodhohen duke bashkuar fllanxhat e lidhjes nga një tub minimal 32x2,5 mm me metodën e saldimit me hark metalik me gaz.

- Për montimin e dorezave të shufrave në shtyllat mbajtëse duhet të përdoren dadot dhe bulonat e kokës me kamer të veshur me gjeomet.

Banka për ushtirimet e barkut

Banka për ushtirimet e barkut duhet të prodhohet nga panele polietileni HDPE (polietilen me dendësi të lartë) me trashësi të paktën 10 mm. Panelet HDPE duhet të jenë të prodhuara dyngjyrëshe, nuk mund të përdoret materiali i cili është ngjyrosur pas prodhimit. Dimensionet e HDPE duhet të jenë minimum 50cmx150cm+/- 10 cm Për t'i menjanuar lakimet dhe deformimet duhet të punohet korniza e hekurt me profile 40x40 mm. Dimensionet duhet të jenë në dimensionet minimale.

#### Paralelet e pavarura

Paralelet duhet të prodhohen nga profilet e lakuara fi në përputhje me vizatimin teknik. Lartësia e tyre duhet të jetë min.100cm dhe gjatësia min.175cm. Për montimin në dysHEME, flanaxhat 140x140x8 mm duhet të saldohen ne pjesen e poshtme.

#### Shufrat bartëse të unazave dhe unazat

Shtyllat bartëse të unazave duhet të jenë nga profilet 100x100x2,5 mm.Shufra në të cilën janë të vendosura unazat gjimnastikore duhet të jetë nga gypi 48x3 mm e cila është e salduar me shtyllën bartëse duke përdorur metodën e saldimit me hark metalik të gazit. Shufra duhet të përmbajë sistemin me rrota për të parandaluar fërkimin e 62unazave levizëse sa duhet të jenë te vendosura në këtë shufër.

#### Paisja multifunksionale

Paisja për ushtrime multifunksionale duhet të jetë me dizajn,funksionalitet dhe dimensione të përcaktuara në vizatimin teknik. Profilet mbajtëse duhet të prodhohen nga tuba 180 cm të gjatë me një diametër minimal prej 140 mm (5") dhe një trashësi muri 3-4,5 mm. Pjesët lëvizëse të lidhura me trupin kryesor duhet të jenë të paktën 60 mm në diametër dhe 3-4 mm të trasha. Krahët e varësës së pajisjes tërheqëse dhe tubi mbështetës i mbështetëses së krahut duhet të prodhohen nga një tub me diametër min 48 mm (1 ¼") 3,5-4 mm trashësi muri.. Doreza tërheqëse dhe pjesët që lëvizin prapa duhet të montohen në trup me një pllake lidhese 140 mm të trashë 4 mm.

- Dy kushineta 6005 2RS duhet të përdoren në shpërndarës të lëvizshëm me nyje U.